



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PYTJET MË TË SHPESHTA REGJISTRIMI DHE VOTIMI JASHTË KOSOVËS



ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E KOSOVËS 2025

1

Kur organizohet votimi në përfaqësi diplomatike?

Me datën 8 shkurt 2025, KQZ do të organizoj votimin në përfaqësi diplomatike.

2

Kur përfundon periudha e aplikimit për regjistrim si votues jashtë Kosovës?

Periudha e aplikimit për tu regjistruar si votues jashtë Kosovës ka filluar me datën 29 gusht 2024 dhe përfundon me datën 26 dhjetor 2024.

3

Si mund të regjistrohem për votim jashtë Kosovës përmes sistemi elektronik?

Nëse jeni shtetas i Republikës së Kosovës dhe jetoni jashtë Kosovës, mund të aplikoni për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës, përmes sistemit elektronik: diaspora.kqz-ks.org

Shënoni numrin tuaj personal dhe datën e lindjes. Pastaj shtypni butonin “Kërko” ku do të shfaqen disa nga të dhënat tuaja, më pas plotësoni të dhënat e kërkuara, si dhe përcaktoheni për një të një nga mënyrat e votimit:

- Përmes Përfaqësive Diplommatike
- Përmes Postës në kutinë postare jashtë Kosovës
- Përmes Postës në kutinë postare në Kosovë.

Më pas plotësoni të dhënat e kërkuara, ju duhet të ngarkoni kopjen e njërit dokument identifikues të Republikës së Kosovës si: letërnjoftimin, pasaportën ose lejen e vozitjes dhe fotografinë tuaj së bashku me dokumentin identifikues të Kosovës në dorë.

4

Si mund të regjistrohem për votim jashtë Kosovës përmes postës?

Hapat që duhet ti ndiqni:

- Plotësoni Formularin e Regjistrimit <https://kqz-ks.org/votimi-jashte-kosoves/>
- Bashkëngjitni kopjen e njërit dokument identifikues të lëshuar nga Republika e Kosovës;
- Nëse dokumenti është i skaduar, duhet të dërgoni kopjen e një dokumenti të vlefshëm të identitetit të shtetit ku jetoni.
- Bashkëngjitni fotografinë tuaj, në të cilën mbani dokumentin identifikues të Republikës së Kosovës.

5

Si bëhet fotografia me dokument identifikues të Republikës së Kosovës në dorë?



6

Nëse kam dokument me afat të skaduar të Republikës së Kosovës, si të veproj?

Nëse dokumenti identifikues i Republikës së Kosovës është me afat të skaduar, duhet të bashkëngjitni kopjen e një dokumenti të vlefshëm të identitetit të shtetit në të cilin jetoni.

7

A mund të aplikoj për regjistrim nëse nuk kam shtetësi të Republikës së Kosovës?

Vetëm shtetasit e Republikës së Kosovës kanë të drejtë të regjistrohen për votim jashtë Kosovës.

8

A mund të regjistrohem me certifikatë apo ekstrakt të lindjes?

Për tu regjistruar me sukses si votues jashtë Kosovës duhet të keni një nga dokumentet identifikues të Republikës së Kosovës (letërnjoftim, pasaportë apo leje të vozitjes).

9

A mund të regjistrohem me dokument të UNMIK-ut?

Për të aplikuar për regjistrim për votim jashtë Kosovës, duhet të keni një dokument identifikues të Republikës së Kosovës (letërnjoftim, pasaportë ose leje vozitjeje). Me dokument të UNMIK-ut nuk mund të regjistroheni me sukses për votim jashtë Kosovës.

10

Çfarë mund të bëj në rast se më është refuzuar kërkesa për regjistrim për votim jashtë Kosovës?

Nëse kërkesa juaj për regjistrim është refuzuar, mund të aplikoni përsëri duke plotësuar dokumentet që kanë munguar.

11

Si mund të parashtrij ankesën për refuzimin e regjistrimit si votuese jashtë Kosovës?

Ankesa mund të parashtroni përmes e-mailit në adresën: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org. Ankesa duhet të përmbajë një fotografi tuaj me dokumentin e identifikues të Kosovës në dorë dhe faktet që mbështesin kundërshtimin tuaj.

12

Nëse jam regjistruar me sukses si votues jashtë Kosovës, a mund të votoj në Kosovë, në ditën e zgjedhjeve me datën 9 shkurt 2025?

Nëse jeni regjistruar si votues jashtë Kosovës, emri juaj do të largohet nga lista e votuesve brenda Kosovës dhe nuk do të mund të votoni në Kosovë në 9 shkurt 2025.

13

A mund të çregjistrohem si votues jashtë Kosovës?

Po, ju mund të çregjistroheni si votues jashtë Kosovës dhe të ktheheni në listën votuese brenda Kosovës. Për ta bërë këtë, duhet të dërgoni një kërkesë brenda 24 orëve pas përfundimit të periudhës së regjistrimit për votim jashtë Kosovës. Kërkesa duhet të përmbajë një fotografi tuaj me dokumentin e identifikues të Kosovës në dorë dhe faktet që mbështesin kundërshtimin, si dhe dëftesën e regjistrimit të nënshkruar dhe dërgoni në email adresën: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org, duke kërkuar çregjistrimin ose anulimin e regjistrimit.

14

A mund të ndryshoj mënyrën e votimit?

Po, mund të ndryshoni mënyrën e votimit. Së pari, duhet të dërgoni në email adresën: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org fotografimin tuaj me dokumentin e identifikues të Kosovës në dorë, më kërkesë për anulim të regjistrimit. Pas anulimit të kërkesës, ju duhet të bëni kërkesën për regjistrim përsëri.

15

Nëse kam shënuar emailin gabim, si të veproj?

KQZ nuk mund të plotësoj informatat e dhëna nga ana juaj. Nëse keni shënuar email të pasaktë ju duhet të paraqisni kërkesë për anulim të kërkesës së aprovuar, në mënyrë që të aplikoni përsëri. Kërkesën për anulim duhet të dërgoni në email adresën: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org duke bashkangjitur fotografën tuaj me dokumentin e identifikues të Kosovës në dorë, më kërkesë për anulim të regjistrimit. Pas anulimit të kërkesës, ju duhet të bëni kërkesën për regjistrim përsëri.

16

Çka është dëftesa e regjistrimit dhe për çfarë nevojitet?

Dëftesa e regjistrimit përmban kodin unik të regjistrimit, i gjeneruar në barkod, dhe shërben për identifikimin e votuesit gjatë periudhës së votimit përmes postës. Dëftesa është e nevojshme për të verifikuar statusin e regjistrimit tuaj dhe për të siguruar që jeni regjistruar për të votuar përmes postës.

Dëftesën e regjistrimit, e cila pranohet përmes e-mailit, duhet ta vendosni në zarfin kryesor, së bashku me zarfin që përmban fletëvotimin.

17

Si realizohet votimi në përfaqësi diplomatike?

Votimi në përfaqësi diplomatike organizohet një ditë para ditës së zgjedhjeve në Kosovë me datë 8 shkurt 2025. Votimi fillon në ora 07:00 dhe mbyllet në ora 19:00, sipas orës lokale të vendit përkatës. Procedura e votimit në vendvotim në përfaqësinë diplomatike, është e njëjtë me procedurën e votimit në vendvotim brenda Kosovës.

18

Kur fillon periudha e votimit përmes postës?

Periudha e votimit përmes postës fillon me datën 9 janar 2025 dhe përfundon me datën 8 shkurt 2025.

19

Cilat janë adresat e kutive postare jashtë Kosovës?

Lidhur me adresat e kutive postare jashtë Kosovës do të njoftoheni përmes emailit para fillimit të periudhës së votimit përmes postës.

20

Kur do ta pranohet fletëvotimin?

Fletëvotimin do ta pranoni para fillimit të periudhës së votimit përmes postës.

21

Si të votoj përmes postës?

Nëse jeni regjistruar suksesshëm si votues jashtë Kosovës, për votim përmes postës, ju mund të pajiseni me fletëvotim, përmes:

- E-mailit, i cili jepet gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim; ose
- Duke e shkarkuar fletëvotimin nga ueb faqja e KQZ-së.

Pasi të plotësoni fletëvotimin, e palosni dhe e vendosni në një zarf të pashënuar dhe mbyllni atë. Zarfën me fletëvotim dhe dëftesën e regjistrimit të pranuar përmes e-mailit, vendoset në një zarf tjetër në të cilin duhet të shënohet adresa e kutisë postare të KQZ-së. Pakon me fletëvotim dërgoni në kutinë postare të hapura nga KQZ.

Dërgesat postare duhet të jenë individuale.

22

Si ta dërgoj pakon me fletëvotim në njërin nga kutit postare të hapur nga KQZ-ja në përfaqësitë diplomatike jashtë Kosovës?

Pakon me fletëvotim mund ta dërgoni në kutinë postare të hapur nga KQZ, nga shteti ku ju jetoni. Pakon duhet ta dërgoni gjatë periudhës së votimit përmes postës, jo më vonë se dita e shtunë kur votohet në përfaqësinë diplomatike.

Për më shumë informata kontaktoni linjën ndihmëse të KQZ-së në WhatsApp dhe Viber: +383 46 61 00 61.